



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut;
Komiteti për Politikë dhe Financa;
Numër: 02-05/23;
Datë: 12.05.2023 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:

FTESE

Për: anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa;
Lënda: mbledhja e pestë (2023) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Vendi: sala e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 19.05.2023, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim – Vendimit për formimin e Grupit të Femrave të Komunës së Junikut;
3. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/28

Datë: 19.05.2023

Në bazë të neneit 12 dhe paragrafit 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008) dhe nenit 22.1 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 31.05.2023 nxjerrë:

Propozim - V E N D I M

Për

Formimin e Grupit të Femrave të komunës së Junikut

I. Me këtë vendim formohet Grupi i Femrave të komunës së Junikut / në tekstin e mëtejme Grupi i Femrave/.

II. Grupi i Femrave përbëhet nga 11 anëtare si në vijim:

- a) Anëtare femra të Kuvendit të Komunës së Junikut (6)
- b) Zyrtarja për barazi gjinore e Komunës së Junikut (1)
- c) Një (1) përfaqësuese nga shkolla (SHFMU “ Edmond Hoxha “ dhe Gjimnazi “ Kuvendi i Junikut “).
- d) Një (1) përfaqësuese nga QMF “ Dr. Ali Hoxha “,
- e) Një (1) përfaqësuese nga Komuniteti i Biznesit, dhe
- f) Një (1) përfaqësuese nga OJQ-të.

III. Anëtarët nga paragrafët c) , d), e) dhe f) të pikës II. të këtij vendimi duhet të delegohen nga subjektet përkatëse brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

IV. Për mbarëvajtjen e punës së Grupit të Femrave e njëjta harton : planin e punës dhe raportin e punës .

V. Projekt dokumentet nga pika IV. e këtij vendimi i procedohen kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

VI. Grupi i Femrave është organ këshillëdhënës, kurse për punën e tij i mpërgjigjet Kuvendit të Komunës.

VII. Mbledhjet e Grupit të Femrave i udhëheqë kryesuesja e cilsa do të zgjedhet në mbledhjen inaguruese.

VIII. Kryesuesja e Grupit të Femrave zgjedhet sipas nenit 8 paragrafi 8.7 të rregullores për punën e komiteve të Kuvendit të Komunës së Junikut.

IX. Mandati i Grupit të Femrave është i njëjt me mandatin e kësaj legjislature të Kuvendit të Komunës.

X. Procedura e zëvendësimit apo shkarkimit eventual të ndonjë anëtareje të Grupit të Femrave bëhet sipas procedurës së njëjtë të miratimit në Kuvendin e Komunës.

XI. Procedura e ndryshimit të këtij apo ndonjë dispozite të këtij vendimi është e njëjtë me procedurën e miratimit.

XII. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen vendimet tjera me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

XIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi _____
kryesues